



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

**V E N D I M**

Nr. 32 datë 28.05.2025

**PËR  
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "LALZI BAY,  
KOMPLEKS ME FUNKSION BANIM, SHËRMBIM, DHE HOTELERI, ME 1, 4 DHE 5  
KATE MBI TOKË DHE 1-2 KATE NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË BIZË,  
BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Xhajs Tirana" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Lalzi Bay, Kompleks me funksion banim, shërbim, dhe hoteleri, me 1, 4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë", me vendndodhje në Bizë, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë "Xhajs Tirana" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË  
DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKI



Nënshkruar më datë 11 /02/ 2026